



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1872, datë 11.04.2012

Për

“Dhënien e miratimit paraprak për transaksionin e pritsëm në tregun e komunikimeve elektronike midis Eagle Mobile Sh.a dhe Altelecom Sh.a dhe për kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP si dhe në Autorizimet e Përgjithshme dhe Individuale tek subjekti tregtar përthithës që do të rezultojë në përfundim të procesit”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 11.04.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Dhënien e miratimit paraprak për transaksionin e pritsëm në tregun e komunikimeve elektronike midis Eagle Mobile Sh.a dhe Altelecom Sh.a dhe për kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP si dhe në Autorizimet e Përgjithshme dhe Individuale tek subjekti tregtar përthithës që do të rezultojë në përfundim të procesit”.

të shoqëruar nga materialet:

- Relacion përmbledhës (*Relacion*);
- Projekt Vendim i KD (*Projekt Akti*);

BAZA LIGJORE:

1. Ligj nr. 9918, datë 19.05.2008, neni 14, 74, 114 dhe neni 115 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Ligj nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Ligj nr. 9901, date 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqerite tregtare” , i ndryshuar ;
4. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918.
5. VKD nr.532, date 26.12.2008 “Per pajisjen me Autorizim Individual sipërmarresin “Eagle Mobile” sh.a, Aneks 4, pika 3.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresat e sipërmarrësit Albtelecom (Nr. 4696 Prot., datë 18. 10. 2011, dhe Nr. 521 Prot., datë 31. 01. 2012)

diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

Ne Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare është depozituar shkresa e Albtelecom sh.a në lidhje me korrespondencën e mëparshme mbi procesin e bashkimit me përthithje të shoqërisë tregtare Eagle Mobile sh.a nga Albtelecom sh.a. Gjithashtu, AKEP është njohur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës “Për disa rekomandime AKEP-it në lidhje me tregun e komunikimeve elektronike” (shkresë nr. 1948,dt.27.12.2011).

Albtelecom sh.a., në kuptim të ligjit “ *Për Komunikimet Elektronike në RSH*”, kërkon nga ana e AKEP një qëndrim/miratim paraprak në lidhje me regjimin e Autorizimeve Individuale dhe Autorizimeve të Përgjithshme të dy kompanive, pas procesit të bashkimit me përthithje të Eagle

Mobile sh.a. nga Albtelecom sh.a., në mënyrë që të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përmbajnë autorizimet e të dy kompanive të gëzohen në një autorizim individual dhe të përgjithshëm të vetëm në emër të shoqërisë që synohet të krijohet.

Po ashtu Albtelecom sh.a thekson se, qëndrimi aprovues i AKEP do të ishte mjaft i mirëpritur, në mënyrë që Albtelecom të proçodojë me hapa të tjerë për finalizimin e këtij proçesi me regjistrimin e shoqërisë së re në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Bashkimi me përthithje midis dy shoqërive Albtelecom sh.a dhe Eagle Mobile sh.a bazuar në nenin 216 , Kreu I “Bashkimi me Përthithje”, ligj nr.9901, dt 14.04.2008 “ *Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, është një fenomen sipas të cilit një shoqëri e vetme tregtare do të marrë jetë nga dy shoqëritë aktuale dhe karakterizohet nga një koncentrim industrial i cili duhet të realizohet nepërmjet disa fazave juridiko-ekonomike-teknike në përfundim të të cilave do të rezultojë krijimi i shoqërisë së re.

AKEP, mbështetur në ligj nr.9901, dt 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (**ligj nr. 9901**) vlerëson paraprakisht vullnetin tregtar të dy shoqërive tregtare , sipërmarrës të ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të autorizuar nga AKEP, për iniciativën e ndërmarre për të dhënë kontribut tregtar të përbashkët në ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike nën veprimtarinë e tyre civile me qëllim fitimi.

Gjithashtu AKEP, bazuar në dispozitat materiale të ligj nr. 9918,dt.19.05.2008 “ Për komunikimet elektronike në RSH” (**ligj. nr. 9918**), tregon interes të veçantë ndaj projektimit të shoqërisë përthithëse që do të rezultojë nga bashkimi i këtyre dy shoqërive në kuadër të marrjes përsipër të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të shoqërive që do të bashkohen.

Të dy subjektet tregtare konkretisht sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a dhe Albtelecom sh.a të themeluar me personalitet juridik për të ushtruar veprimtari tregtare bazuar në ligjin nr. 9901 dhe të autorizuar për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike bazuar në ligj nr.9918, janë subjekte të rregjistruara në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit bazuar në ligj nr. 9723 “ Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”. Proçesi i ardhshëm juridiko-ekonomik i dëshiruar dhe deklaruar nga palët ndër të tjera pritet të pasohet me ndryshime në të dhënat e rregjistrimit për shoqëritë aksionere mbështetur në Statutin e QKR dhe aktet e tjera me fuqi nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit.

Për të materializuar qëllimin e përbashkët tregtar këto shoqëri tregtare duhet të regjistrojnë çdo ndryshim në QKR të të dhënave të njoftuara në formularin e aplikimit dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjistër. Në këtë kuadër, nisur nga lloji dhe natyra e shërbimit të ofruar prej tyre i cili lidhet ngushtësisht me objektin e autorizimeve të nxjerra dhe mbikqyrura nga AKEP, atehere administrativisht vlerësohet se dhënia e këtij miratimi paraprak i cili formalizon dakortësinë dhe pëlqimin administrative të Autoritetit do të shërbejë të dyja palëve

tregtare respektivisht për të finalizuar pritshmërine e kërkuar prej tyre përpara institucioneve publike në funksion të realizimit të qëllimit të shprehur.

Për sa më sipër, AKEP do të ndjekë me vëmendje të gjitha hapat proceduriale të ndjekur nga sipërmarrësit e tij në kuadër të këtij procesi tregtar në mënyrë që të ushtroje pushtetin e tij diskrecional mbi aktet e nxjerra prej tij dhe në fuqi.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Dhënien e miratimit paraprak për transaksionin e pritshëm në tregun e komunikimeve elektronike midis Eagle Mobile Sh.a dhe Altelecom Sh.a dhe për kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP si dhe në Autorizimet e Pergjithshme dhe Individuale, tek subjekti tregtar përthithës që do të rezultojë në përfundim të procesit”.
2. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**